



Programi i Studimit dhe profesorët ekselentë të Universitetit të Firences synojnë të përgatisin arkitektë me aftësi dhe kompetenca të plota **në sektorin e projektimit, design-it, teknologjisë, restaurimit dhe rikualifikimit.**

Arkitektura në UNIZKM i përgjigjet kërkesës së tregut për specialistë në ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri.



ARKITEKTURË



Kontakte



Rruga Dritan Hoxha, Tiranë



Tel: 04 22 73 290 – Fax: 04 22 73 291



c.architettura@unizkm.al



@unikzkm



@unikzkm



@UNIKZKM



unikzkm



Universiteti Katolik Zoja e Keshillit te Mire



**UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

NË BASHKËPUNIM ME
UNIVERSITETIN E FIRENCES



INFORMACIONE RRETH PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i Studimit në Arkitekturë është një cikël i integruar 5-vjeçar (300 ECTS). Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën italiane nga profesorët ekselentë të partnerit akademik, Universitetit të Firences, vatra italiane e kulturës.

Programi i studimit parashikon praktika mësimore dhe profesionale pranë studiove më të njohura të arkitekturës, në Shqipëri dhe jashtë vendit.

Në përfundim të studimeve lëshohet **Diplomë e Dyfishtë** “*Master i Shkencave në Arkitekturë*”, e vlefshme në Shqipëri, Itali dhe vendet e Bashkimit Evropian.

I diplomuari ka kualifikimet për të marrë titullin e Arkitektit Senior dhe është i përgatitur të lëvrojë në sektorët e projektimit, urbanistikës, design-it, teknologjisë, restaurimit dhe rikualifikimit të ambjenteve ekzistuese.

PËRSE ARKITEKTURA NË UKZKM ËSHTË ZGJEDHJA E DUHUR?

- Ndërton të ardhmen si arkitekt përmes formimit multidisiplinor me standarte akademike dhe profesionale evropiane.
- Arkitekti që formohet në UKZKM ka një rol thelbësor në shoqërinë bashkëkohore, si profesionist i aftë të interpretojë dhe ndryshojë fenomenet që karakterizojnë qytetin, komunitetin dhe vetë individin.
- Programi është një rrugëtim drejt kulturës së projektimit, ndërthurjes së intelektit me krijimtarinë e kërkesës së rehatisë me teknologjinë, e estetikës me funksionalen, si dhe proceseve transformuese me ato historiko-ekonomike.
- Arkitektura në UKZKM iu përgjigjet kërkesave të tanishme të tregut për specialistë të fushës, sidomos në ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri.

PERSPEKTIVAT PROFESIONALE TË ARKITEKTIT TË DIPLOMUAR NË UKZKM

Gjatë ciklit 5-vjeçar, ndërthurja e njohurive teknike me traditën aplikohen në disiplina të ndryshme të fushës së arkitekturës. Aspektet sociale, kulturore, historike, ekonomike lidhen me ato projektuese, teknologjike e restauruese. Profesionisti fiton aftësinë e analizës bashkëkohore të qytetit, vlerave monumentale dhe mjedisit.

Në mbarim të ciklit të integruar 5-vjeçar *Arkitekti Senior* është një figurë aktive në shoqëri si:

- profesionist i pavarur ose në studio projektimi
- drejtues dhe koordinues në institucione publike dhe private
- përgjegjës për projektimin, realizimin, restaurimin e ndërtesave, si dhe në fushën e design-it industrial, planifikimit urban dhe të territorit

Përfundimi i Programit Master i Shkencave mundëson vazhdimin e karrierës akademike dhe kërkimore nëpërmjet ciklit të Doktoraturës në të gjitha fushat e Arkitekturës.